



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 4 gusht 2014
Nr.ref.:RK686/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI66/14

Parashtrues

**Ruhan Sadiku, Zymrije Hyseni, Ramadan Palushi,
Xhevat Haziri, Mehdi Dibra dhe Aziz Hashani**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Gjykatës Supreme të
Republikës së Kosovës, Rev. nr. 210/13, të 18 dhjetorit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë: z. Ruhan Sadiku nga fshati Llugaxhi, komuna e Lipjanit; znj. Zymrije Hyseni nga fshati Prelez, komuna e Ferizajt; z. Ramadan Palushi nga Ferizaj; z. Xhevat Haziri nga Ferizaj; z. Mehdi Dibra nga Ferizaj dhe z. Aziz Hashani nga Ferizaj. Parashtruesit përfaqësohen nga z. Halil Ilazi, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 210/13, të 18 dhjetorit 2013, të cilin e kanë pranuar më 15 janar 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë, me të cilin pretendohet se parashtruesve të kërkesës u janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 31, paragrafi 1 dhe 2 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]; nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt Gjyqësor] si dhe nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: Konventa).

Baza juridike

4. Baza juridike është: neni 113.7 i Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 4 prill 2014, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 6 maj 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 16 maj 2014, Gjykata i njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi Gjykatës Supreme një kopje të kërkesës.
8. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi me shkrim Gjykatën, për përjashtimin e tij nga seancat shqyrtuese, për periudhën qershor - korrik 2014, derisa Gjykata të vendosë, përkitazi me pretendimet e ngritura ndaj tij.
9. Më 30 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës e zëvendësoi gjyqtarin Kadri Kryeziu me gjyqtarin Ivan Čukalović, si anëtar të Kolegjit shqyrtues.
10. Më 3 korrik 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 27 mars 2004, Kompania Publike e Transportit të Udhëtarëve "Kosovatrans" (në tekstin e mëtejme: "Kosovatrans") vendosi që parashtruesit e kërkesës t'i dërgojë në pushim me pagesë prej 50% (Vendimi nr. 46).

12. Më 30 dhjetor 2005, Gjykata Komunale në Ferizaj (Aktgjykimi: C. nr. 250/05) vendosi që: i) ta aprovojë si të bazuar, kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës dhe e anuloi si të kundërligjshëm vendimin e “Kosovatrans”-it, për dërgimin e tyre në pushim me pagesë prej 50% të të ardhurave personale; ii) ta detyrojë “Kosovatrans”-in që t’i kthejë parashtruesit në vendet e tyre të punës, me të gjitha të drejtat dhe obligimet nga marrëdhënia e punës; iii) ta detyrojë “Kosovatrans”-in që parashtruesve të kërkesës t’ua kompensojë pagat e humbura prej 1 prillit 2004 deri më 30 dhjetor 2005, me kamatë në lartësi prej 4%, të llogaritur prej 30 dhjetorit 2005 deri me pagesën përfundimtare; ta detyrojë “Kosovatrans”-in që parashtruesve të kërkesës t’ua paguajë dëmin në lartësinë e mëditjeve për periudhën prej 1 prillit 2004 deri më 30 dhjetor 2005, me të njëjtën kamatë në lartësi prej 4%, prej 30 dhjetorit 2005 deri me pagesën përfundimtare; dhe v) ta detyrojë “Kosovatrans”-in që parashtruesve të kërkesës t’ua kompensojë shpenzimet e kontestit.
13. “Kosovatrans”-i ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale.
14. Më 1 nëntor 2006, Gjykata e Qarkut (Aktgjykimi: Ac. nr. 168/2006), vendosi që: I) ta refuzojë si të pabazuar ankesën e “Kosovatrans”-it, në paragrafin I, II dhe në pjesën e paragrafit III të aktgjykimit që ka të bëjë me kompensimin e dëmit për të ardhurat personale të papaguara, për periudhën prej 1 prillit 2004 deri më 30 dhjetor 2005; II) ta vërtetojë paragrafin V të aktgjykimit; III) ta prishë paragrafin III të Aktgjykimit, në pjesën që ka të bëjë me lartësinë e kamatës prej 4%, që do të llogaritet prej 30 dhjetorit 2005 deri me pagesën përfundimtare; dhe IV) ta anulojë kërkesën në paragrafin IV.
15. Më 5 dhjetor 2006, parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesë për përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj (C. nr. 250/2005, të 30 dhjetorit 2005).
16. Më 20 dhjetor 2006, Gjykata Komunale lejoi përmbarimin dhe e urdhëroi “Kosovatrans”-in që t’i kthejë parashtruesit e kërkesës në vendet e tyre të punës dhe t’ua kompensojë pagat e papaguara prej 2 prillit 2004 gjer më 30 dhjetor 2005.
17. Më 19 shkurt 2007, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) parashtrroi kërkesë për shtyrjen e përmbarimit për shkak të privatizimit të një pjese të “Kosovatrans”-it.
18. Më 23 prill 2007, Gjykata Komunale (Aktvendimi E. nr. 1348/06), refuzoi kërkesën e AKM-së, dhe e përsëriti detyrimin e “Kosovatrans”-it, që t’i kthejë parashtruesit në vendet e tyre të punës, me kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.
19. Më 27 shtator 2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimi: Ac. nr. 448/2007) e refuzoi si të pabazuar ankesën e AKM-së dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj, E. nr. 134/2006, të 23 prillit 2007.

20. Më 19 nëntor 2007, Gjykata Komunale konkludoi (E. nr. 1348/2006, shënim zyrtar) se *“Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Ferizaj C. Nr. 250/05 i 30.12.2005 është përmbartuar në tërësi, ashtu që [parashtruesit e kërkesës] janë kthyer në punë dhe janë futur në lokalet e debitorit”*.
21. Më 7 maj 2009, Gjykata Komunale në Ferizaj (Aktgjykimi C. nr. 676/06) vendosi që: i) ta aprovojë kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës dhe ta obligojë “Kosovatrans”-in që parashtruesve të kërkesës t’ua paguajë pagat e papaguara për periudhën prej 1 janarit 2006 deri më 30 prill 2009, dhe ii) ta refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës, sipas të cilës “Kosovatrans”-i është i detyruar të paguajë për triskat e ushqimit për periudhën prej 1 prillit 2004 deri më 30 prill 2009.
22. Më 10 maj 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimi Ac. nr. 881/2009) refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesve të kërkesës dhe vërtetoi ankesën e “Kosovatrans”-it.
23. “Kosovatrans”-i dhe AKP-ja ushtruan revizion në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të shkallës së dytë, për shkak të shkeljeve substanciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.
24. Më 18 dhjetor 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 210/2013) vendosi që: I) ta pranojë revizionin e “Kosovatrans”-it; II) t’i ndryshojë aktgjykimet e Gjykatës Komunale në Ferizaj (C. nr. 676/2006 të 7 majit 2009) dhe të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë (Ac. nr. 881/2009 të 10 majit 2012) ashtu që kërkesëpadia e parashtruesve të kërkesës lidhur me detyrimin e “Kosovatrans”-it që t’u kompensojë parashtruesve të kërkesës pagat e papaguara për periudhën prej 1 janarit 2006 deri më 30 prill 2009 është refuzuar si e pabazuar; dhe III) mosshqyrtimin e pjesës së mbetur të aktgjykimeve.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se *“Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 210/2013, i 18 dhjetorit 2013, është i njëanshëm, i padrejtë dhe arbitrar për arsyt si në vijim:*
 - a). *Njëanshmëria, padrejtësia dhe arbitrariteti procedural. Përkundër faktit se çështja e gjykuar res judicata është parim themelor absolut dhe paraqet prezumim procedural negativ që përjashton mundësinë e rigjyimit për të njëjtën çështje njëherë të gjykuar, e sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme merret se ndërprerja e marrëdhënies së punës (ka ndodhur) për shkak të privatizimit, edhe për kundër faktit se ky kundërshtim njëherë është refuzuar me vendim të plotfuqishëm, si fakt i "lindur", një fakt i rilindur apo i ringjallur, sepse ai fakt është shuar se ekzistuari me vendimin e formës së prerë E. nr. 1248/2007 pa asnjë bazë tjetër ligjore, paraqet njëanshmëri, arbitraritet dhe padrejtësi procedurale.*
 - b) *Njëanshmëria dhe arbitrariteti procedural ka shkaktuar edhe njëanshmërinë dhe padrejtësinë materiale në dem të paditësve me ndryshim të aktgjykimeve të gjykatave të instancave me të ulëta”*.

26. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme kishte shkelur “nenin 31.1 dhe 2 (E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm), nenin 22 (Zbatimi i drejtpërdrejt i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare), nenit 54 (Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 par 1 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenit 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”.
27. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu i referohen Aktgjykimit të Gjykatës në Rastin K108/09, të nxjerrë më 17 dhjetor 2010.
28. Parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që “ta ndryshojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, ashtu që revizioni i ushtruar nga paditësi të refuzohet si i pabazuar”.

Pranueshmëria e kërkesës

29. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesit e kërkesës i kanë plotësuar kërkesat e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës.
30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.
31. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) c) dhe 36 (2) d) i Rregullores së punës, parasheh që:
 - (1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

[...]

c) kërkesa nuk është qartazi e bazuar.
 - (2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;

[...]

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.
32. Parashtruesit pretendojnë se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 210/13, i 18 dhjetorit 2013, është i njëanshëm, i padrejtë dhe arbitrar, për shkak se gjykata në fjalë i ndryshoi vendimet e gjykatave të instancës më të ulët, të cilat ishin të formës së prerë dhe të detyrueshme, *res judicata*.
33. Gjykata vëren se “Kosovatrans”-i kishte të drejtë të ushtrojë revizion në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimeve të gjykatave të instancave më të ulëta.
34. Gjykata konsideron se një vendim i gjykatës së instancës më të ulët nuk mund të konsiderohet i formës së prerë dhe i detyrueshëm, përderisa palët kanë të

drejtë të ushtrojnë ankesë kundër tij në instancë më të lartë gjyqësore, siç është rasti konkret.

35. Gjykata më tej vëren se, Gjykata Supreme shqyrtoi çështjet, e ngritura në revizion duke dhënë arsye të hollësishme dhe gjithëpërfshirëse.
36. Në të vërtetë, Gjykata vëren se Gjykata Supreme kishte vlerësuar drejt situatën procedurale, duke theksuar:

[...]

Më datën 14.08.2006., që do të thotë para se është marrë aktgjykimi i shkallës së dytë Ac. Nr. 168/2006 dhe para se lënda është dërguar për rigjykim, përmes Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit është bërë privatizimi i të paditurës ["Kosovatrans"-i], si pasojë e së cilës një numri të madhe të punëtorëve, në mesin e tyre edhe paditësve, iu është përfunduar punësimi. Agjencia Kosovare e Mirëbesimit për këtë i ka informuar punëtorët - edhe të paditurit dhe ky fakt po ashtu në mes palëve nuk është kontestuese. Si pasojë e kësaj ka lindur pamundësia ligjore që paditësit të kthehen në vendet e tyre të punës, përkundër nxjerrjes së konkluzionit të gjykatës së shkallës së parë E. nr. 1348/2006 të datës 19.11.2007. më të cilin paditësit kthehen në punë të e paditura, për tu ekzekutuar aktgjykimi i parë i kësaj gjykate C. Nr. 250/2005 i datës 30.12.2005. Paditësit nuk kanë ushtruar kundërshtim kundër njoftimeve për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 14.08.2006, edhe pse këtë të drejtë ligjore e kanë pas".

37. Më saktësisht, Gjykata Supreme theksoi:

"Gjykata komunale në Ferizaj sërish ka gjykuar çështjen e cila me aktgjykimin e Gjykatës së qarkut në Prishtinë Ac. nr. 168/2006 të datës 01.11.2006. është kthyer në rigjykim, për të vendosur vetëm në pjesën e cila është kthyer në rigjykim, pra, lidhur me kamatën dhe kompensimin e shujtës. Mirëpo, duke ngelur pranë kërkesëpadisë për shujtën, paditësit kanë ndryshuar, kërkesëpadinë duke prezantuar padinë e ndryshuar me shkrim më datën 29.02.2008. ashtu që i tërë objekti i shqyrtimit dhe i vendosjes me aktgjykimin e ri në pjesën e aprovimit të kërkesëpadisë, ka qenë kompensimi i të ardhurave nga puna për periudhën 2006.-2009., siç me detaisht u përshkrua më lartë".

38. Gjykata Supreme konstatoi:

"... nga provat e administruara del se më datën 14.08.2006. është bërë privatizimi i të paditurës si tërësi dhe në shkresat e lëndës gjenden informatat zyrtare të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit të dërguara paditësve në të cilat thuhet se pasoja e shitjes së aseteve të paditurës është përfundimi i punësimit të tyre, ndërsa kërkesat e punëtorëve lidhur me pagat do të shqyrtohen në procedurat e likuidimit. Janë të bazuara edhe pretendimet në revizion (e) se dërgimi i paditësve në pushim me pagesë prej 50 % të ardhurave nuk është i ndërlidhur me përfundimin e punësimit të tyre për shkak të privatizimit të paditurës, e cila paraqet bazë tërësisht tjetër për ndërprerjen e marrëdhënies së punës

Vendimi që të paditurve iu ndërpritet marrëdhënia e punës nuk është marrë nga e paditura por nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit”.

39. Përfundimisht, Gjykata Supreme gjeti se *“e drejta materiale nuk është aplikuar drejt, për çka aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët u ndryshuan si në dispozitiv”.*
40. Gjykata konsideron se Aktgjykimi (C. nr. 250/05) i Gjykatës Komunale në Ferizaj, i 30 dhjetorit 2005, i cili pretendohet të jetë bërë i formës së prerë dhe i detyrueshëm, nuk e prek Aktgjykimin (C. nr. 676/06) të gjykatës së njëjtë, të 7 majit 2009, i cili është objekt i revizionit të kontestuar të Gjykatës Supreme. Këto aktgjykime janë të ndërlidhura, por ato janë të ndara dhe të ndryshme.
41. Përveç kësaj, Aktgjykimi i 30 dhjetorit 2005 ka të bëjë me të ardhurat personale të parashtruesve të kërkesës, për periudhën prej 1 prillit 2004 deri më 30 dhjetor 2005, përderisa Aktgjykimi i 7 majit 2009, që ka të bëjë me të ardhurat personale të parashtruesve të kërkesës për periudhën prej 1 janarit 2006 deri më 30 prill 2009.
42. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk kanë shpjeguar dhe dëshmuar si dhe pse konstatimi i Gjykatës Supreme se, *“e drejta materiale nuk ishte aplikuar drejt nga gjykatat e instancës më të ulët”* është i njëanshëm, i padrejtë dhe arbitrar, gjegjësisht ka shkelur parimet e *res judicata*.
43. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës e bazojnë arsyetimin e tyre në praktikën gjyqësore të Gjykatës, përkatësisht duke pretenduar se rasti i tyre është i ngjashëm me KIo8/09 (Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2010).
44. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se rrethanat faktike të rastit KIo8/09 nuk janë të ngjashme me ato të parashtruesve të kërkesës. Në të vërtetë, në rastin KIo8/09, Gjykata konstatoi shkelje lidhur me mospërmbarimin e vendimit të shkallës së parë, i cili u bë i formës së prerë, sepse nuk ishte ushtruar asnjë ankesë kundër tij: në rastin e parashtruesve të kërkesës, palët e pakënaqura, siç u cek më lart, me legjitimitet të plotë, ushtruan revizion në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimeve të gjykatave të instancës më të ulët.
45. Prandaj, rrethanat e rastit të parashtruesve janë dukshëm të ndryshme nga rrethanat e Rastit KIo8/09, kështu që parashtruesit e kërkesës nuk mund t'i referohen atij, për ta mbështetur pretendimin e tyre. Për më tepër, Gjykata thekson se në Rastin KIo9/09, *“Dhoma e Posaçme, e kishte refuzuar ankesën e AKM-se, duke thënë se (...), AKM ka dorëzuar (...) duke ofruar argumente të detajuara që ekskluzivisht merreshin me meritat e aktgjykimin të lëshuar në janar 2002. Sipas Dhomës së Posaçme, ishte e qarte se AKM po përpiqej të ankohej ndaj aktgjykimin të vitit 2002. Për më tepër, Gjykata Komunale ishte kompetente për të vendosur për padinë e janarit 2002, dhe se ky aktgjykim nuk ishte ankimuar e rrjedhimisht ishte bërë i formës së prerë (res judicata)...”.*
46. Përveç kësaj Dhoma e Posaçme vlerësoi se AKM-ja, *“që ishte themeluar sipas Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 të datës 13 qershor 2002, që do të thotë se*

është themeluar pasi qe vendimi i Gjykatës Komunale i datës 11 janar 2002 u bë res judicata...”.

47. Për më tepër, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me aktgjykimin e nxjerrë nga Gjykata Supreme. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë marrë ato dëshmi (shih, rasti *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87 Raport i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).
48. Në rastin konkret, Gjykata nuk konsideron që procedurat në Gjykatën Supreme, kanë qenë të njëanshme ose në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
49. Gjykata Kushtetuese më tej konsideron se pretendimi për shkelje, i bazuar në mosrespektim të vendimit të formës së prerë dhe të detyrueshëm është i pabazuar, pasi që faktet dhe argumentet e paraqitura nga parashtruesit e kërkesës nuk shpjegojnë në mënyrë logjike dhe nuk dëshmojnë në mënyrë të arsyeshme se Gjykata Supreme ka shkelur parimet *res judicata*.
50. Rrjedhimisht, nuk ka nevojë për shqyrtim të mëtejme të shkeljeve të tjera të pretenduara, siç janë të përmbledhura dhe të përfshira në pretendimin e parashtruesve për shkelje të të drejtave për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe për mjete efektive.
51. Si përmbledhje, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesve është qartazi e pabazuar, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) c) 36 (2) b) dhe d); dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 3 korrik 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani